

[Data 04 /12 /2023]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "BLERJE SHËRBIMI PËR AKTIVITETE TË NDRYSHME PËR BASHKINË TIRANË"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79952000-2 Shërbime të organizimit të eventeve; 79952100-3 Shërbime të organizimit të eventeve kulturore

1. 49,942,951 (dyzetë e nëntë milion e nëntëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa tvsh, ose 490,839.813 (katërqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë pikë tetëqind e trembëdhjetë) Euro pa TVSH

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është 1,951,650.00 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh ose 19,180.835 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë pike tetëqind e tridhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

*** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 04/12/2023 is 101.75 ALL/EUR**

3. Burimi i financimit: vënë në dispozicion me anë të VKB-së nr. 126 datë 23.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023" me objekt: "Blerje shërbimi për aktivitete të ndryshme për Bashkinë Tiranë".

Marreveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj

Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë: Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: 3 (tre) (minimumi 2 (dy) Operatorë Ekonomikë të kualifikuar).

Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

- Do të ketë rihapje të konkursit.
- Bashkia Tirane do të përgatitë një ftesë për ofertë dhe do t'u dërgojë, në të njëjtën kohë, vetëm operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, pa bërë njoftim publik.
- Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë do të përcaktojë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, kriteret e përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave.
- Drejtoria përkatëse për ndjekjen e Marrëveshjes Kuadër në mënyre periodike do të evidentojë kërkesat për zhvillimin e aktiviteteve si dhe afatin e ofrimit të shërbimit të tyre. Procesi i mini konkurrencës për lidhjen e kontratës do të zhvillohet sa herë që institucioni Bashkia Tirane do të ketë nevojë dhe të dhëna të mjaftueshme për kryerjen e aktivitetit.
- Kriteri i vleresimit ne rastin e rihapjes së konkurimit për lidhjen e kontratës do te jete: Çmimi më i ulët i ofertës, por në çdo rast ofertuesit nuk duhet të tejkalojnë vleren e ofruar të deklaruar në ofertat e shpallura fituese.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: “Shërbimi për realizimin e aktiviteteve te ndryshme”, do të jetë për një periudhë kohore 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Në varësi të aktivitetit që do të kryhet në vende te ndryshme të territorit të Bashkisë Tiranë, sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të shërbimeve, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues pas procesit të minikonkursit, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e shërbimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit si dhe kosto shtesë për AK. Të gjithë zërat e artikujve të shërbimit që do ofrohen për zhvillimin e aktiviteteve sipas kërkesave të AK janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, pra janë të gjithë si një komponent i vetëm në funksion të njëra tjetrës.

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e shërbimeve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, rrjedhimisht nga mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatorë ekonomikë të ndryshëm, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i

vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permblendes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose loti, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Kjo procedurë është është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2020,2021,2022,) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.*

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:

- a) Standartin ISO 9001:2015 (ose e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij

për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

b) Standartin ISO 27001:2013 (ose e përditësuar) për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë ne përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me:

- zërat përcaktuar në dokumentin e specifikimeve teknike dhe kontratës në tërësi;
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë;
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive;
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Realizimi i sa më sipër, kërkon ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese si dhe në informacione sensitive të Bashkisë Tiranë, si rrjedhojë certifikimi ISO 27001 i operatorit ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, trajtimin e të dhënave dhe shërbimeve që do të kryhen.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit

2.3.3 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, duhet të ketë në dispozicion një staf prej minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës, të cilët do të jenë përgjegjës për mbarëvajtjen teknike, montimin/çmontimin e pajisjeve teknike të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore (e-Sig02/a) ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 4 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”,

si dhe pika 8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës bazuar në analizën e kryer për kërkesën për punonjës të specializuar/të kualifikuar referuar kriterit 2.3.4

Numri i personave të stafit të kërkuar është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë procedurë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një personel teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me këto kompetenca:

2 (dy) Teknik Audio

2 (dy) Teknik Ndricimi

2 (dy) Teknik Video

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme për periudhën e zbatimit të Kontratës;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit e Sig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B

Shënim: Kriteri 2.3.4 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...]

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41, pika 4.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose

komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Nisur nga kërkesat teknike dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf në fushat e sipërpërmendura, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës.

Kërkesa për personel teknik, i shërben Autoritetit Kontraktor për tu njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses dhe janë të domosdoshme duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimeve të kërkuara referuar kërkesave teknike si dhe shumëllojshmërinë e aktiviteteve të planifikuara, të tilla si evente/ aktivitete për promovimin e qytetit, atraksione turistike, vlerave kulturore apo inagurime, projekte, prezantime të punëve të kryera nga Bashkia e Tiranës e jo vetëm, aktivitete sociale/kulturore/ekonomiko-politike etj, si dhe pritje-përcjellje me delegacione diplomatike vendase dhe të huaja.

i. Teknikët audio, video dhe ndriçimi janë të domosdoshëm pasi kryejnë disa detyra në funksion të mbarëvajtjes së ofrimit të shërbimit të kërkuar për zhvillimin e aktiviteteve:

- Garantojnë suport teknik perfekt përgjatë përgatitjeve dhe përgjatë performancave/ eventeve në mënyrë që të garantohet supporti teknik i kërkuar nga aktiviteti;
- Furnizojnë paisjet sipas kërkesave dhe nevojave në mënyrë që të mbështesë aktivitetet e planifikuara;
- Mbajnë përgjegjësi për të gjithë paisjet dhe materialet në përdorim;
- Sigurojnë mirëmbajtje rutinë që të garantojë funksionin korrekt të të gjithë paisjeve dhe mbështjeten e strukturave të jashtme;
- Mbështesin në grumbullimin dhe shpërndarjen e pajisjeve të kërkuara për të siguruar ekzekutimin në kohë të aktiviteteve të planifikuara;
- Kujdesen për vendosjen e lidhjeve për transmetim;
- Kontrollonjë pajisjet regjistruese për një funksionim sa më të efektshëm;
- Kontrollonjë pajisjet për të redaktuar përzierje të imazheve dhe regjistrimeve zanore, për të siguruar cilësi dhe efekte të kënaqshme;

Veprojnë me pajisjet e duhura profesionale dhe monitorojnë sistemet audio dhe video për të transmetuar, për të marrë sinjale dhe për të rregulluar gamën e tingujve dhe qartësinë e ngjyrave të regjistrimeve apo transmetimeve.

Kërkesa e AK për paraqitjen e listëpagesave sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B, shërben në vetvete si garanci paraprake për realizimin dhe zbatimin e kontratës përgjatë periudhës së sipërcituar, duke qenë se nuk ka mënyrë tjetër të besueshme për të vërtetuar disponibilitetin e stafit sipas kualifikimeve të kërkuara, në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe zbatimit të saj.

AK e vendos këtë kriter, duke pasur parasysh peshën specifike të angazhimit të cdo anëtari të stafit për realizimin e shërbimeve objekt kontrate dhe është faktor besueshmërie për Autoritetin Kontraktor pasi krijon bindjen se cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë, duke finalizuar kështu një kontratë të suksesshme.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret janë vendosur për të garantuar aftësinë e Operatorit Ekonomik për të realizuar në kohë dhe me cilësi implementimin e kontratës dhe mirëmbajtjes për periudhën e specifikuar.

Kërkesat më sipër janë garanci për Autoritetin Kontraktor se nëpërmjet zgjidhjes që do të përdoret për ndërtimin e sistemit Operatori ekonomik i ka kuptuar kërkesat dhe funksionalitetet e përcaktuara në termat e referencës.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë nga administratori i shoqërisë:

1. se marrin përsipër transportimin, montimin, mbarëvajtjen teknike, çmontimin dhe largimin e pajisjeve pas përfundimit të çdo aktiviteti, të gjitha pajisjet teknike të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit në vendin përkatës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

2. se disponojnë pajisjet teknike për realizimin e kontrates duke përcaktuar në deklaratë llojin dhe specifikimet teknike për çdo pajisje të kërkuar referuar preventiv, shoqëruar me foto të tyre.

3. se disponojnë mjetet dhe pajisjet/ aparaturat teknike si më poshtë dhe këtë e vërtetojnë me dokumentacionin e nevojshëm që vërteton pronësinë ose me kontratë qeraje, ose cdo akt tjetër juridik (të vlefshme):

- të paktën **40 m2** Ekran Led me rezolucion jo me shume se **4 mm** për eventet që Autoriteti Kontraktor do të organizojë në ambientet e brendshme.

- të paktën **120 m2** Ekran Led me rezolucion jo më shumë se **8 mm** për eventet që Autoriteti Kontraktor do të organizojë në ambientet e jashtme/të brendshme.

Shënim: Kriteri 2.3.5 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 41, të pika 5/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin e mallit objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor me shpenzimet e tij. Për kryerjen e transportit, duhet të disponojë 2 (dy) mjete tip kamion dhe 1 (një) mjet transporti tip furgon të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

Në rastet kur mjeti është në pronësi: *Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit- Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS); taksa vjetore.*

Në rastet kur mjeti është me qera: *Kontratë Qeraje noteriale për gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi; Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit- Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS); taksa vjetore.*

Shënim: Kriteri 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 41, të pika 5/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për mjetet e mësipërme i shërben Autoritetit Kontraktor për tu njohur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses dhe janë të domosdoshme duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, kohëzgjatjen e saj, si dhe natyrën e shërbimeve të kërkuara referuar kërkesave teknike si dhe shumëllojshmërinë e aktiviteteve të planifikuara, të tilla si evente/ aktivitete për promovimin e qytetit, atraksione turistike, vlerave kulturore apo inagurime, projekte, prezantime të punëve të kryera nga Bashkia e Tiranës e jo vetëm, aktivitete sociale/kulturore/ekonomiko-politike etj, si dhe pritje-përcjellje me delegacione diplomatike vendase dhe të huaja.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga

ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Bashkia Tiranë ka nisur planifikimin dhe ideimin organizativ të Samitit B40, planifikim të aktiviteteve që mund të organizohen në kuadër të çmimeve që mund të fitohen përgjatë vitit 2024, si dhe aktivitetet, eventet me drejtoritë, ceremonitë protokollare etj.

Duke konsideruar presidencën e Samitit B40, nismës së ndërmarrë në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës “Shqipëria Mikpret Botën”, në të cilën cdo shtet do të ketë “Javën e Kulturës”, evente në kuadër të titullit pretendent “Tirana Kryeqyteti i Demokracisë”, inaugurime, prezantime, konferenca, si dhe projekte të Drejtorive të Bashkisë Tiranë.

Struktura e specializuar/ Grupi i punës, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/testimin e tregut dhe përlllogaritjen e fondit limit për objektin që prokurohet, përcaktoi fondin limit duke u bazuar në ndarjen e bërë nga struktura përkatëse e menaxhimit të aktiviteteve në Bashkinë e Tiranës për 3 lloje aktivitesh (3 set up). Organizimi i 1 (një) set up të madh ku do të ketë një konferencë ndërkombëtare për Samitin B40, mbrëmja e mirëseardhjes si dhe mbrëmja Gala në kuadër të Samitit B40, 14(katërmbëdhjetë) aktivitete të mesme (set up i mesëm) si dhe 75 (shtatëdhjetë e pesë) evente në formë inaugurimesh, prezantimesh et (set up i vogel) .

Specifikimet teknike dhe kërkesat funksionale janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “**Blerje shërbimi për aktivitete të ndryshme për Bashkinë Tiranë**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit

NJËSIA E PROKURIMIT